




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Komisioneri për të Drejtën e Informimit
dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale



KOMISIONERI PËR TË DREJTËN
E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN
E TË DHËNAVE PERSONALE

UDHËZUES

Si të plotësoj dokumentin zyrtar

“Formulari i Njoftimit”

Për Përpunimin e të Dhënave Personale

Pasqyra e Lëndës

	Faqe
○ Hyrje	-
○ Ilustrim i plotësimit të dokumentit zyrtar “ <i>Formulari i Njoftimit</i> ” për Përpunimin e të Dhënave Personale.	-

HYRJE

Ligji nr. 9887, datë 10.03.2008, ndryshuar me ligjin Nr. 48/2012 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, përcakton rregulla për mbrojtjen dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave personale, si dhe kompetencat e Institucionit të pavarur *“Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*.

Një nga detyrimet që kanë subjektet kontrollues, të cilët, sipas Nenit 3/3 të ligjit, *“janë çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo njësi tjetër, të cilët, vetëm apo në bashkëpunim me të tjerë, mbajnë, përpunojnë, administrojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhënat personale”*, është përgjegjësia për të njoftuar, bazuar në Nenin 21 të këtij ligji.

Ky nen parashikon se *“çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i qëllimit të përpunimit, të njoftuar më parë”*.

Në kuadrin e këtij detyrimi, si dhe në kuadrin e zbatimit të kompetencave të Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me Vendimin Nr. 66, datë 01.10.2009 të Komisionerit është miratuar Formulari i Njoftimit si dhe Udhëzuesi për plotësimin e tij, bazuar në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar.

Udhëzuesi është përgatitur me qëllim që t’i shërbejë subjekteve kontrollues si orientim dhe t’i sqarojë për çdo rubrikë të këtij formulari gjatë plotësimit të tij.

Njoftimi, nëpërmjet formularëve, është një proces me anën e të cilit kontrolluesit e të dhënave personale njoftojnë Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në lidhje me të dhënat që ato përpunojnë gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

Formulari i njoftimit është i zbatueshëm vetëm për një rast të përpunimit të të dhënave personale dhe përditësohet nga kontrolluesi çdo herë kur ka një ndryshim të qëllimit/ ose informacioneve të tjera deklaruara më parë.

Ky informacion i dhënë nga kontrolluesit, do të pasqyrohet nga Zyra e Komisionerit në një Regjistër i cili do të jetë i hapur për publikun në faqen zyrtare: www.idp.al

Qëllimi primar i njoftimit dhe pasqyrimi i informacionit në këtë regjistër është transparenca ndaj publikut. Bërja me dije ose mundësia që i jepet publikut për t’u informuar se kush përpunon të dhëna personale, si dhe detaje të tjera të procesit, si p.sh. qëllimi i përpunimit, është një parim bazë i mbrojtjes së të dhënave personale. Ky regjistër do të pasqyrojë informacion në nivel të përgjithshëm, por me detaje të mjaftueshme për të krijuar një tablo të qartë të procesit. Pra njoftimi i shërben interesave të publikut, duke

e ndihmuar të kuptojë se si përpunohen të dhënat personale nga subjektet kontrollues.

Gjithashtu, plotësimi i detyrimit për njoftim, në kuadrin e plotësimit të kërkesave dhe kriterëve të përgjithshme të mbrojtjes së të dhënave të parashikuara nga ligji, do të rrisë ndërgjegjësimin dhe përgjegjësinë e vetë subjekteve kontrolluese.

Zyra e Komisionerit e ka hartuar këtë formular në përputhje me qëllimet e parashtruara më lartë, duke u përpjekur të kufizohet në detajet e tepërta dhe të minimizojë procesin, por duke respektuar kërkesat ligjore.

Si të plotësojmë Formularin e Njoftimit

1. Të dhënat e Kontrolluesit

1.1 Të dhënat e subjektit kontrollues

Këtu duhet të plotësohet prej jush emri i saktë ligjor i kompanisë, shoqërisë, i personit fizik, organit administrativ etj.

Të plotësohet duke dhënë adresën e plotë dhe të saktë të godinës ku ushtron aktivitetin institucioni juaj. Nëse aktiviteti shtrihet në vende të ndryshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, përcaktoni adresën e qendrës (godinës qendrore) ku ushtroni aktivitetin.

Jepni numrin ose numrat e saktë me anën e të cilëve mund të kontaktoheni.

Jepni adresën e e-mailit dhe të faqes zyrtare në internet me anën e të cilave mund të kontaktoheni.

Në varësi të aktivitetit tuaj ligjor lutemi zgjidhni një nga opsionet e mëposhtme nëse keni një aktivitet privat fitimprurës zgjidhni opsionin “*privat*”, nëse jeni një institucion shtetëror opsionin “*publik*” dhe nëse ushtroni një aktivitet jo-fitimprurës dhe jeni të regjistruar si të tillë ligjërisht zgjidhni opsionin “*organizatë jo-fitimprurëse*”.

Specifikoni saktësisht numrin tuaj NIPT me anë të të cilit rezultoni të regjistruar në zyrat e tatim-taksave. Nëse subjekti juaj nuk ka NIPT atëherë do të rishkruani edhe njëherë emrin e subjektit.

1.2 Personi i kontaktit i ngarkuar nga subjekti kontrollues

Kjo nënrubrikë pritet të plotësohet prej institucionit tuaj nëse paraprakisht keni përcaktuar një person i cili është përgjegjës për menaxhimin e procesit të përpunimit të të dhënave personale, gjatë ushtrimit të aktivitetit tuaj, si dhe që mund të kontaktohet nga Zyra e Komisionerit për mbarëvajtjen e procesit të njoftimit edhe në vijim. **Këshillojmë që pranë institucionit tuaj të përcaktohet një person kontakti, të cilit mund t'i ngarkohet kjo detyrë përveç funksionit që ka në institucion, me qëllim mbarëvajtjen e**

procesit të njoftimit. Të dhënat në lidhje me personin e kontaktit nuk do të pasqyrohen në regjistrin e hapur për publikun.

☒ Deklaratë e parë ☐ Deklaratë Ndryshimi (specifiko Nr. e Regjistrimit)

1. Të dhënat e Kontrolluesit

1.1 Të dhënat e subjektit kontrollues

Emri i Subjektit Fizik ose Juridik	ABC Projekt sh.p.k.
Adresa	RR. Dëshmoret e Kombit
Nr. i Telefonit	0422XXXXX
Nr. Faksit	0422XXXXX
e-Mail, Website	www.abcproje.com, abcproje@abcproje.com
Lloji i Aktivitetit	☒ Privat ☐ Publik ☐ Organizatë jo-fitimprurëse
N.I.P.T.	K1234567890B

1.2 Personi i kontaktit i ngarkuar nga subjekti kontrollues

Emër	Flamur
Mbiemër	Bushi
Adresa	Rr. Dëshmoret e Kombit, pall. 12, app. 124
Nr. i telefonit	0422XXXXX
Nr. i Faksit	0422XXXXX
e-Mail	abcproje@abcproje.com

2 Fusha e Veprimtarisë

Në këtë rubrikë mund të zgjidhni një ose më shumë opsione që përkojnë me fushat e listuara dhe përmbledh veprimtarinë tuaj ligjore që ushtroni. Nëse nuk e gjeni veten në asnjë nga fushat e listuara lutemi kliko në kuadratin “të tjera specifiko” dhe më pas shpjegoni ose vendosni të plotë objektin e

veprimtarisë njësoj me atë të deklaruar në QKR

2. Fusha e Veprimtarisë

☐ Institucion Shtetëror	☐ Shërbime Marketingu	☐ Shërbime Katering
☐ Shëndetësi	☐ Partnership Privat	☐ Shoqëri Sigurimesh
☐ Institucion Fetar	☒ Shoqëri Tregtare	☐ Agjenci Kreditimi
☐ Shoqëri Shtetërore	☐ Shërbime Financiare	☐ Transport Publik
☐ Vetëpunësim	☐ Shërbime Turizmi	☐ Edukim
☐ Masedia	☐ Telekomunikacion	

☐ Të tjera (specifiko)

3 Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen (Të përcaktohen kategoritë e subjekteve të cilëve u përpunohen të dhënat)

Këtu duhet të zgjidhni një ose më shumë opsione për të përcaktuar se cilës kategori të mëposhtme i përkasin subjektet e të dhënave që ju përpunoni, duke patur parasysh se me “subjekt i të dhënave” kuptohet çdo person fizik të cilit i përpunohen të dhënat personale:

3. Kategoritë e subjekteve të të dhënave personale që përpunohen (Të përcaktohen kategoritë e subjekteve të cilëve u përpunohen të dhënat)

☐ Nënpunës	☐ Anëtarë	☐ Studentë
☒ Klientë	☒ Punëmarrës	☐ Pacientë
☐ Aksionerë	☒ Furnizues	☐ Përfutues të asistencës sociale

☐ Të tjera (specifiko)

Nëse personat për të cilët ju përpunoni të dhënat e tyre personale janë të ndryshëm nga lista e sipërpërmendur, lutemi specifikoni pasi të keni klikuar në kuadratin “të tjera specifiko”.

4 Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen (Të përcaktohen të dhënat që përpunohen për secilën nga kategoritë e subjekteve të deklaruara në rubrikën 3)

Tabela e mëposhtme përmban një numër kategorish të përgjithshme që ju mund të përpunoni në lidhje me aktivitetin tuaj dhe duhet të plotësoni një ose disa nga kuadratet përkatës. Duhet të keni parasysh se e “dhënë personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social.”.

4. Kategoritë e të dhënave personale që përpunohen (Të përcaktohen të dhënat që përpunohen për secilën nga kategoritë e subjekteve të deklaruara në rubrikën 3)

☒ Të dhënat e identifikimit (emër, mbiemër, gjinia, inicialet, vendlindja, datëlindja)	☒ Numri personal i identifikimit
☒ Numri i sigurimit shoqëror	☒ Jeta profesionale
☒ Formimi - Diplomat - Medaljet	☐ Situata ekonomike e financiare
☒ Adresa	☐ Të dhëna biometrike
☐ Tinguj	☒ Imazhe nëpërmjet kamerave të Vëzhgim-Regjistrimit (CCTV)
☒ Foto	
☐ Të tjera (specifiko)	

Duke marrë në konsideratë që ju mund të përpunoni kategori të dhënash të ndryshme nga ato të listuara në formular, ju mund të klikoni në kuadratin “të tjera” dhe të vijoni duke saktësuar se cilat janë këto të dhëna.

Vini Re!! Nëse përpunoni të dhëna personale “Imazhe nëpërmjet kamerave të Vëzhgim-Regjistrimit (CCTV)” referojuni Udhëzimit të Komisionerit Nr. 3, datë 05.03.2010 mbi “Mbi përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera, i ndryshuar”.

5 Të dhënat Sensitive që përpunohen (Të përcaktohen të dhënat sensitive që përpunohen për secilën nga kategoritë e subjekteve të deklaruara nga ju në rubrikën 3)

Nëse ju nuk përpunoni asnjë nga kategoritë e të dhënave sensitive lutemi të zgjidhni opsionin “nuk përpunohen të dhëna sensitive”. Nëse **po** dhe keni zgjedhur opsionin “përpunohen të dhëna sensitive”, zgjidhni një ose më shumë opsione që i korrespondojnë të dhënës ose të dhënave sensitive që përpunoni.

5. Të dhëna sensitive që përpunohen (Të përcaktohen të dhënat sensitive që përpunohen për secilën nga kategoritë e subjekteve të deklaruara nga ju në rubrikën 3)

5.1 ☐ Nuk përpunohen të dhëna sensitive

5.2 ☒ Përpunohen të dhëna sensitive

☐ Rraca dhe etnia	☐ Opinioni politik	☐ Besimi fetar dhe filozofik
☒ Shëndeti	☐ Jeta seksuale	☒ Gjendja penale
☐ Anëtarësimi në Bashkime Sindikata		

Vini re!!! Bazuar në nenin 7 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, “me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 2 të këtij neni, ndalohej përpunimi i të dhënave, që zbulojnë origjinën racore ose etnike, mendimet politike, anëtarësinë në

sindikata, besimin fetar apo filozofik, dënimet penale, si dhe shëndetin dhe jetën seksuale”. Për rastet përjashtimore të parashikuara në pikën 2 të këtij neni (shih ligjin).

6 Qëllimi i Përpunimit (Të përcaktohen qëllimet e përpunimit për secilën nga kategoritë e subjekteve të deklaruar nga ju në rubrikën 3)

Kjo rubrikë do të konsiderohet nga më të rëndësishmet, pasi qëllimit të përpunimit të të dhënave personale i është kushtuar një vëmendje e veçantë nga ligjvënësi në Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Sipas këtij ligji përpunimi i të dhënave personale duhet të jetë një proces i bazuar në ligj dhe i drejtë, duke garantuar mbrojtjen maksimale të subjekteve të këtyre të dhënave.

6. Qëllimi i përpunimit (Të përcaktohen qëllimet e përpunimit për secilën nga kategoritë e subjekteve të deklaruar nga ju në rubrikën 3)

☐ Shërbime Publike	☒ Menaxhim i Pronës	☐ Konsulencë dhe Shërbime Këshilluese
☐ Kontabilitet dhe Audit	☐ Edukim	☐ Shërbime Financiare dhe Këshillim
☐ Shërbime Ligjore	☐ Shërbime Turistike	☒ Menaxhim të Burimeve Njerëzore
☐ Administrim Siguracioni	☐ Statistikor	☐ Reklamim, Marketing dhe Marrëdhënie me Publikun
☐ Menaxhim Hotelerie	☒ Tregti	☒ Mbikëqyrje të ambjenteve nëpërmjet kamerave Vëzhgim-Regjistrimi (CCTV)
☐ Administrim Shëndetësie	☐ Dhënie Kredie	
☐ Të tjera (specifiko)		

Plotësimi i kësaj rubrike realizohet duke zgjedhur opsionet sipas qëllimit ose qëllimeve përkatëse të përpunimit të të dhënave.

Theksojmë, duke kërkuar vëmendjen maksimale tuajën gjatë plotësimit të kësaj rubrike, se mund të zgjidhni disa opsione nëse përpunimi i të dhënave personale realizohet nga ana juaj për shkak të disa qëllimeve.

7 Marrësi i të dhënave personale

7.1 Nuk ka përhapje të dhënash personale tek të tjerë

“Marrësi i të dhënave personale” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër të cilit i janë dhënë të dhënat e një pale të tretë ose jo. Autoritetet, të cilat mund të marrin të dhëna në kuadrin e një hetimi të veçantë, nuk konsiderohen si marrës.

Në këtë rubrikë, nëse nuk ka një përhapje të “të dhënave” lutemi zgjidhni opsionin “nuk ka përhapje të dhënash personale tek subjekte të tjera kontrolluese”. “Marrësit” mund të jenë subjekte kontrollues, institucione private dhe shtetërore që i jepen të dhëna prej jush

7. Marrësi i të dhënave personale

7.1 ☐ Nuk ka përhapje të dhënash personale tek subjekte të tjera kontrolluese

7.2 ☒ Ka përhapje të dhënash

7.2.1 ☒ Subjekti marrës

7.2.2 ☒ Qëllimi i përhapjes (specifiko)

7.2 Ka përhapje të dhënash

Nëse **PO**, zgjidhni opsionin “ka përhapje të dhënash personale”.

7.2.1 Subjekti marrës

Në këtë nënrubrikë përcaktoni subjektin ose subjektet që u jepen këto të dhëna prej jush.

7.2.2 Qëllimi i përhapjes

Qëllimi i përhapjes duhet të specifikohet në kuadrin e aktivitetit që ushtron institucioni juaj.

8 Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

8.1 Nuk ka transferim të dhënash personale

Me “*Transferim Ndërkombëtar*” kuptojmë dhënien e të dhënave personale “*marrësve*” në shtetet e huaja.

Nëse nuk kryeni një proces të tillë, zgjidhni opsionin “*nuk ka transferim të të dhënave personale*”.

Vini re!!! Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*”, transferimi ndërkombëtar lejohet vetëm në ato shtete me nivel të përshtatshëm të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale. Vendet me nivel të mjaftueshëm për mbrojtjen e të dhënave janë përcaktuar në listën që i bashkëlidhet Vendimit të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale Nr.3, datë 20.11.2012 “*Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*”.

Në vendet e tjera transferimi bëhet vetëm me pëlqimin e subjektit të të dhënave dhe vetëm nëse e parashikojnë aktet ndërkombëtare ku Republika e Shqipërisë është palë. Sipas nenin 9 të këtij ligji për transferim në vende të ndryshme nga ato të parashikuara në nenin 8, transferimi bëhet vetëm me autorizimin e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

8. Transferimi ndërkombëtar i të dhënave personale

8.1 ☐ Nuk ka transferim të dhënash personale

8.2 ☒ Ka transferim të dhënash personale

8.2.1 Transferimi i të dhënave personale drejt vendeve të përcaktuara në listën që i bashkëlidhet Vendimit nr. 3 datë 20/11/2012 “*Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*”

(specifiko) Itali, Gjermani, France

8.2.2 Transferimi i të dhënave personale jashtë vendeve të përcaktuara në listën që i bashkëlidhet Vendimit nr. 3 datë 20/11/2012 “*Për përcaktimin e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale*”

(specifiko) Emiratet e Bashkuara Arabe, Katar

8.2.3 Frekuenca e transferimeve

☐ 1 Herë ☒ Periodikisht ☐ Vazhdimisht

8.2.4 ☒ Mjetet dhe mënyrat e transferimit të të dhënave

(specifiko) transferimi kryhet nepermjet.....

8.2.5 ☒ Qëllimi i transferimit

(specifiko) qellimi i transferimit eshte.....

8.2 Ka transferim të dhënash personale

Nëse ju kryeni një proces të tillë, zgjidhni opsionin “*ka transferim të të dhënave personale*” dhe vijoni me plotësimin e nënrubrikave.

8.2.1 Transferimi i të dhënave personale drejt vendeve të përcaktuara në listën që i bashkëlidhet Vendimit Nr.3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

8.2.2 Transferimi i të dhënave personale jashtë vendeve të përcaktuara në listën që i bashkëlidhet Vendimit Nr.3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

Për njoftimin që bëhet në mënyrë manuale, kontrolluesi paraprakisht duhet të konsultohet me faqen zyrtare të Komisionerit www.idp.al dhe të klikojë në listën që i bashkëlidhet Vendimit Nr.3, datë 20.11.2012 “Për përcaktimin e shteteve, me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave personale”.

8.2.3 Frekuenca e transferimeve.

Këtu duhet të specifikoni se sa i shpeshtë është transferimi ndërkombëtar i të dhënave që ju përpunoni, duke zgjedhur opsionet përkatësisht nëse transferoni vetëm një herë, vazhdimisht apo transferimi i këtyre të dhënave realizohet nga ju periodikisht.

8.2.4 Mjetet dhe mënyrat e transferimit të të dhënave.

Specifikoni në këtë rubrikë duke përmendur ekzaktësisht sesi transferohen të dhënat, si p.sh. në rrugë elektronike, me postë zyrtare, me mjete të tjera komunikimi etj.

8.2.5 Qëllimi i transferimit

Specifiko arsyet dhe qëllimin e transferimit ndërkombëtar të të dhënave që ju përpunoni në lidhje me aktivitetin tuaj.

9 Mjetet e përpunimit të të dhënave personale

Kjo nënrubrikë ka të bëjë me mënyrën sesi përpunohen të dhënat personale.

9. Mjetet e përpunimit të të dhënave personale

9.1 ☒ Mekanike

9.2 ☒ Instrumente elektronike (kompjuter, programe kompjuterike dhe çdo mjet elektronik ose automatik, me të cilat bëhet përpunimi)

9.1 Mekanike

Nëse të dhënat përpunohen atëherë zgjidhni këtë opsion.

9.2 Instrumente elektronike (kompjuter, programe kompjuterike dhe çdo mjet elektronik ose automatik, me të cilat bëhet përpunimi)

Nëse të dhëna përpunohen nëpërmjet Instrumenteve elektronike (kompjuter, programe kompjuterike dhe çdo mjet elektronik ose automatik, me të cilat bëhet përpunimi) atëherë zgjidhni këtë opsion.

Gjithashtu mund të zgjidhni të dyja opsionet nëse ju përpunoni të dhënat personale në të dyja mënyrat.

10 Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale

10.1 Masat e marra për të mbrojtur të dhënat personale në kuadrin e përpunimit jo të ligjshëm të tyre

Në këtë pjesë rubrikë kërkohet të specifikohet me “po” ose “jo” duke zgjedhur opsionet përkatëse, nëse institucioni juaj tashmë ka hartuar, miratuar dhe zbaton disa rregulla konkrete të cilat bëjnë të mundur garancinë e sigurimit të të dhënave që përpunohen nga ana juaj. Këto rregulla mund të jenë sanksionuar në ndonjë akt të brendshëm, si p.sh. “Rregullorja e Brendshme” e cila përcakton zhvillimin e aktivitetit tuaj, pjesë e së cilës mund të jetë edhe “sigurimi i të dhënave personale që përpunohen” ose rregullore të veçantë që përcakton sigurimin e këtyre të dhënave.

Me anën e këtyre rregullave garantohej mospërpunimi i pa autorizuar dhe jo i ligjshëm i të dhënave personale. Gjithashtu përcaktohen masa për të evituar dëmtimin ose shkatërrimin e të dhënave. Përgjigja e pyetjeve të kësaj rubrike është konceptuar në një nivel të përgjithshëm, por që siguron informacion të mjaftueshëm për Zyrën e Komisionerit për të kuptuar rreth sigurisë të sistemeve tuaja teknike ose fizike të përpunimit të të dhënave personale.

10.2 Masat e marra për sigurinë e të dhënave që transferohen ndërkombëtarisht

Në kuadrin e sigurisë së të dhënave që transferohen ndërkombëtarisht specifikoni masat e sigurisë që aplikoni, sipas mënyrës që ju realizoni transferimin e tyre.

10. Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale

10.1 Për të garantuar një nivel të përshtatshëm sigurie, tregoni çfarë masash janë marrë për të mbrojtur të dhënat personale kundër përpunimit jo të ligjshëm të tyre:

A ka një rregullore të brendshme që flet për mbrojtjen e të dhënave personale? ☒ JO ☐ PO

A keni vendosur rregulla për të drejtën e aksesit në të dhënat personale? ☐ JO ☒ PO

A keni marrë masa për të mbrojtur instrumentet elektronike nga ndërhyrjet e jashtme? ☐ JO ☒ PO

Siguria teknike ☐ JO ☒ PO

Siguria fizike ☐ JO ☒ PO

☐ Data backup copies ☒ Hyrje e kufizuar në të dhëna

☒ Fjalëkalim hyrës ☐ Alarme

☒ Antivirus ☒ Zyra të kyçura

Të tjera (specifiko)

10.2 Nëse realizoni transferim ndërkombëtar të të dhënave specifikoni çfarë masash sigurie aplikoni

**Të dhënat e mbledhura do të përpunohen në mënyrë automatike. Këto të dhëna do të mbahen nga Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me ligjin nr. 9887 datë 10/03/2008. Bazuar në nenin 21 të këtij ligji përmbushja e kësaj deklarate është e detyrueshme.*

Emër/Mbiemër: _____	Për Zyrën e Regjistrimit: _____
Firma: _____	Marrë nga: _____
Data: _____	Vlerësuesi: _____
	Data: _____
Vula: _____	

Vini re!!! Kjo rubrikë, bazuar në nenin 26/2 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, nuk do të pasqyrohet në Regjistrin e Hapur për Publikun.

Sqarim përfundimtar

Në fund të këtij formulari, nëse plotësohet manualisht pas rubrikës 10 (dhjetë), lutemi të plotësoni krahun e majtë të faqes me të dhënat e personit që ka firmosur zyrtarisht këtë formular, firma e tij, data dhe vula e institucionit tuaj, nëse formulari përcillet me postë ose dorëzohet personalisht pranë Zyrës së Komisionerit.

Pjesa tjetër e mbetur e formularit, në krahun e djathtë, plotësohet nga Zyra e Komisionerit dhe është pjesë e procedurave të brendshme administrative.

Nëse ju, pas regjistrimit, duhet të njoftoni ndryshime në qëllimin e përpunimit dhe të çdo rubrike të deklaruar më parë, si kërkesë e Nenit 21/1 të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, ju mund ta bëni këtë në formular duke zgjedhur opsionin *“Deklaratë Ndryshimi”* dhe pastaj të plotësoni rubrikën përkatëse që dëshironi të ndryshoni.

Formulari plotësohet në faqen zyrtare *“online”* të Zyrës së Komisionerit www.idp.al dhe pas plotësimit, të dhënat ngarkohen në sistemin e brendshëm të institucionit ku vijnë procedurat e brendshme institucionale.

Në rast pamundësie të plotësimit dhe dërgimit online të formularit ju mund ta printoni nga faqja zyrtare në internet ose ta tërhiqni atë pranë zyrës tonë, ta plotësoni dhe ta dërgoni me postë në adresën:

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Vini Re!!! Asnjë formular nuk do të pranohet i paplotë, i palexueshëm, me gabime dhe jashtë standardit të kërkuar.

Bazuar në Nenin 39/d të Ligjit Nr. 9887, datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*, i ndryshuar *“Kontrolluesit që nuk përmbushin*

*detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit të Nenit 21 të këtij ligji,
dënohen me gjobë 10 000 deri në 500 000 lekë”.*

Regjistri i Subjekteve Kontrollues është elektronik dhe pjesë e Sistemit të
Përgjithshëm të Zyrës së Komisionerit.

Për çdo informacion apo sqarim të mëtejshëm mos hezitoni të kontaktoni
Zyrën e Komisionerit në adresën dhe në numrin e telefonit:

**Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave
Personale**

Rruga "Abdi Toptani", Tiranë

Tel: +355 42237200